



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

Nr. _____ Prot. _____

Kavajë më ____ . ____ . 2024

PROJEKT – VENDIM

DATE ____ / ____ / 2024

Për

Dhënien e titullit QYTETAR NDERI, për mësuesit e shquar SHKËLZEN dhe DHURATA KARKINI me motivaacionin:

“Për kontributin e çmuar dhënë në shërbim të edukimit të brezave të nxënësve. Konkretizimit në përditshmëri të një stili shembullor komunikimi në procesin mësimor dhe edukativ në shkollë e jashtë saj. Me profesionalizëm të lartë ka arritur të fitojë admirimin e të gjithëve duke ruajtur e përsosur me dinjitet të lartë misionin e lartësisë të detyrës së mësuesit në çdo aspekt”.

Në mbështetje të nenit 54 gërma “m” të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në Ligjin Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, në Ligjin 8480, date 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, në Ligjin Nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave për dhënien e medaljeve dhe titujve vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë”, në Kodin e Procedurave Administrative, në mbledhjen e radhës, Kryetari i Bashkisë Kavajë i kërkon Këshillit të Bashkisë Kavajë:

TË VENDOSË:

1. Dhënie e titullit **QYTETAR NDERI**, për mësuesit e shquar **SHKLËLZEN KARKINI** dhe **DHURATA KARKINI**.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Kulturës, Trashigimisë Kulturore, Turizmit dhe Sporteve me motivacionin:

DREJTORIA E KULTURËS, TRASHIGIMISË KULTURORE, TURIZMIT DHE SPORTEVE

GENTIAN JAUPI

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

ARTI ÇIÇOLLI

DREJTORIA LIGJORE

ADRIAN MALAJ

NËNKRYETARE BASHKISË

ESTER STEFA

SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

MERI BITURKU

KRYETARI

FISNIK QOSJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

Nr. _____ Prot. _____

Kavajë më ____ . ____ . 2025

PROCES – VERBAL

Për dhënie titulli “QYETAR NDERI” të mësuesve SHKËLZEN KARKINI dhe DHURATA KARKINI.

I mbajtur sot me datë ____ / ____ / 2025, nga Komisioni ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë me Nr.933 prot. Date ____ / ____ / 2025, per
dënien e titullit “QYETAR NDERI” të mësuesve Shkëlzen Karkini dhe Dhurata Karkini me motivacionin:

“Për kontributin e çmuar dhënë në shërbim të edukimit të brezave të nxënësve. Konkretizimit në përditshmëri të një stili shembullor komunikimi në procesin mësimor dhe edukativ në shkollë e jashtë saj. Me profesionalizëm të lartë ka arritur të fitojë admirimin e të gjithëve duke ruajtur e përsosur me dinjitet të lartë misionin e lartësisë të detyrës së mësuesit në çdo aspekt”.

Komisioni u mbledh dhe mori në shqyrtim kërkesën e bërë me datë ____ / ____ / 2025 me Nr. Prot. _____, nga një grup qytetarësh të Kavajë, dhe vendosi si më poshtë:

1. Dhënien e titullit “QYTETAR NDERI ” për mësuesit e shquar SHKËLZEN KARKINI dhe DHURATA KARKINI.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Kulturës, Trashigimisë Kulturore, Turizmit dhe Sporteve.

KOMISIONI

ESTER	STEFA (Kryetare)
Gentian	Jaupi (Anetar)
Stefanaq	Sotja (Anetar)
Rifat	Hoxha (Anetar)
Fatmira	Rrena (Anetar)

RELACION

Mbi bazën e prpopzimit të bërë nga Kryetari i Bashkisë së qytetit Kavaje z. FISNIK QOSJA si dhe në referencat e paraqitura nga z. Xhaferr Xhihani dhe z. Fatmir Efica, për të nderuar me titullin **“Qytetar Nderi” të Kavajës**, mësuesit e shquar, bashkëshortët **SHKËLZEN KARKINI** dhe **DHURATA KARKINI**, referuar kontributeve përgjatë tërë jetës së tyre në Gjimnazin **“Medar Shtylla”** (sot quhet Aleksandër Moisiu”), duke i shërbeyr me devotshmëri të gjitha brezava të nxënësve dhe përmbushur me shumë dinjitet misionin e rëndësishëm të edukimit të brezave të rinj që kanë dalë nga ky Gjimnaz në qytetin e Kavajës, edhe në këndvështrimin e vlerave të mëdha mësimore e edukative që kanë transmetuar, Drejtoria e Kulturës, Trashigimisë Kulturore, Turizmit dhe Sporteve

I PROPOZON KËSHILLIT BASHKIAK

Dhënien e titullit **QYTETAR NDERI i KAVAJËS**, të mësuesve të shquar **SHKËLZEN KARKINI** dhe **DHURATA KARKINI** me motivacionin:

“Për kontributin e çmuar dhënë në shërbim të edukimit të brezave të nxënësve. Konkretizimit në përditshmëri të një stili shembullor komunikimi në procesin mësimor dhe edukativ në shkollë e jashtë saj. Me profesionalizëm të lartë ka arritur të fitojë admirimin e të gjithëve duke ruajtur e përsosur me dinjitet të lartë misionin e lartësisë të detyrës së mësuesit në çdo aspekt”.

Shkëlzen KARKINI, është me origjinë nga Kosoiva por ka lindur në qytetin e Kavajës në vitin 1934. Ka mbaruar shkollën e mesme Pedagogjike në Shkodër e më pas në Universitetin e Tiranës në degën Matematikë – Fizikë ku është diplomuar në vitin 1956. Emërohet mësues në Gjimnazin **“Merdat Shtylla”** të Kavajës ku në shkencat egzakthe vecmas lëndëve Matëematikë e Fizikë ka dhënë edhe lëndën e Astronomisë. Me bagazhin e nivelin e dijeve arriti të shpalojë aftësi të spikatura. Pas viteve 1978-të ka kryer në disa periudha edhe detyrën e Drejtorit të Gjimnazit. Ka dhënë një shembull të shkëlqyer drejtuesi me integritet profesional e dinjitet të madh vlerash intelektuale e shoqërore. Është nderuar për punën shumë të mirë edhe me tituj të ndryshëm në vite e dekada si **“Mësues i merituar”**, **“Mirënjohje”** në 100-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë më 2012.

Dhuratata KARKINI ka lindur në Tiranë në vitin 1937. Shkollën e mesme e kreu në Kryeqytet. Po kështu edhe studimet e Larta për degën Gjuhë e Huaj (Rusisht). U emërua pas diplomimit të saj në Gjinnazin "Medar Shtylla" të Kavajës, ku pas një eksperience të shkurtër, për arsye familjare, punoi si metodiste në Ministrinë e Arsimit. U rikthye në Kavajë në fillim të viteve 1970-të. Pas njohjeve me Shkëlzen Karkjini çifti i mësuesve të dalluar zyrtarizoi martesën e tyre. Kështu të dy në të njëjtin front e mision të rëndësishëm për edukimin e breëz të ri, Shkëlzen dhe Dhurata Karkjini janë një binom i pandarë në rolin e mësuesve të shquar, deri sa dolën në pension. Kontributet e tyre janë mjaft të spikatura si edukatorë, mësues plot pasion dhe profesionalizëm që është vlerësuar nga opinioni arsimdashës dhe qytetar i Kavajës.

Mbështetur në propozimin e bërë nga Kryetari i Bashkisë Kavajë z. FISNIK QOSJA dhe referencat e paraqitura nga z. Xhaferr Xhahani dhe z. Fatmir Efiça, si dhe në tërë opinionin e rëndësishëm vlerësues që ka qyteti i Kavajës për këtë dy mësues të shquar, shpresojmë se Këshilli Bashkiak do të marrë në konsideratë dhe votojë për të nderuar me titullin "QYTETAR NDERI" z. Shkëlzen KARKINI dhe Dhurata KARKINI.

DREJTORI

GENTIAN JAUPI



PROPOZIM

Drejtuar: Këshillit Bashkiak - Kavajë

Mbështetur në Ligjin 112/2013, për "Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendore të Nderit në Republikën e Shqipërisë, si dhe të Ligjit Nr. 139/ 2015, për "Vetëqeverisjen vendore", nisur nga roli shumë i rëndësishëm si edukatorë të brezit të ri, profesionalizmi shembullor treguar përgjatë tërë jetës së tyre në detyrën e mësuesve, nga shembujt tepër pozitivë që ua kanë shtuar vlerat në mënyrë shumë dinjitoze, çiftit Karkini, mësues Shkëlzeni dhe mësuese Dhurata, që kanë shërbyer në Arsimin e Kavajës dhe u shndërruan në modele nderimi e krenarie, mbështetur në CV-të, në angazhimin maksimal dhe kryerjen me sukses dhe korrektesë të admirushme të të gjitha impenjimeve për afro 5 (pesë) dekada,

I PROPOZOJ KËSHILLIT BASHKIAK KAVAJË

Nderimin me titullin: "QYTETAR NDERI TË KAVAJËS" të mësuesve të shquar:

- 1). Shkëlzen Karkini
- 2). Dhurata Karkini

Me motivacionin:

"Për kontributin e çmuar dhënë në shërbim të edukimit të brezave të nxënësve. Konkretizimit në përditshmëri të një stili shembullor komunikimi në procesin mësimor dhe edukativ në shkollë e jashtë saj. Me profesionalizëm të lartë ka arritur të fitojë admirimin e të gjithëve duke ruajtur e përsosur me dinjitet të lartë misionin e lartësisë të detyrës së mësuesit në çdo aspekt".

Në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak, uroj që ky propozim të merret në konsideratë e të përmbushë atë detyrim ndaj njerëzve me kontribute madhore për Kavajën, siç janë mësuesit e shquar Shkëlzen dhe Dhurata Karkini.

Me respekt

FISNIK QOSJA

Kavajë, më 13.03.2025



REFERENCE



shtë padiskutim mjaft i cmuar vlerësimi i figurave të rëndësishme të jetës publike në Kavajë. Përmes të cilëve me kontributet e tyre gjatë tërë jetës, kanë kryer shërbime që i kanë vlejtur dukimit të brezave të nxënësve që ka nxjerrë Kavaja në mbi pesë dekadat e fundit.

Mësuesit e shquar dhe njëkohësisht bashkëshortë SHKËLZEN dhe DHURATA KARKINI, përfaqësojnë për qytetin tonë një model të rëndësishëm jo vetëm profesional. Por edhe familjar, shoqëror, qytetar e mbi të gjitha kanë qenë një model vlerash si edukatorë që kanë sjellë në vëmendjen e komunitetit arsimdashës të Kavajës dhe jo vetëm.

Me kulturë të gjërë dhe komunikim të arsyeshëm, logjik, argumentues, duke interpretuar cdo gjë me saktësi shembullore, ata me shumë dinjitet kanë punuar me kërkesa të larta për mësimdhënie. Patën arritur të ndërtonin mardhënie të shëndetshme pune me kolegët e tyre në Gjimnazin "Medar Shirtylla (sot "Aleksandër Moisiu"), duke patur shkallë të gjërë njohurish dhe komunikim më të tërë dinjitetin e kësaj fjalë, kanë sjellë një frymë të shëndetshme për të kuptuar, vlerësuar e marrë emocione të papërsritshme në përvetësimin e dijeve.

Kavaja, është një qytet që ka treguar gjithnjë, vëmendjen sistematike madje, për procesin e vlerësimit të figurave të rëndësishme të jetës publike. Nga ky këndvështrim mësuesit e shquar dhe bashkëshortët Shkëlzen Kartkini dhe Dhurata Karkini që tërë jetën e tyre ja dedikuan Arsimit, meritojnë edhe vlerësimin e lartë qytetar, në vecanti në këtë moshë që janë tani, pasi gëzojnë vërtetë respekt maksimal në komunitet.

Në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Kulturës, Trashigimisë Kulturore, Turizmit dhe Sporteve, mbështes propozimin e bërë nga Kryetari i Bashkisë Kavajë, drejtuar Këshillit Bashkiak, për të nderuar me titullin "Qytetar Nderi" z. Shkëlzen Karkini dhe znj. Dhurata Karakini.

Në Librin e Artë të nderitit për Kavajën, padiskutim e meritojnë që të jenë edhe mësuesit e shquar Shkëlzen Karkini dhe Dhurata Karkini si misionarë të dijes e Kulturës duke ngritur e lartësuar emrin dhe traditat arsimdashëse të qytetit të Kavajës aty ku e meriton.

GENTIAN JAUPI